



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM
PËR MBLEDHJE PLENARE
25 Mars 2024

Informacion mbi mbledhjen:

Dita/Data:	E Hënë, 25.03.2024
Ora:	10.00
Kohëzgjatja:	~ 120 min.
Thirrur nga:	Kryetari i Këshillit
Pjesëmarrësit:	Anëtarët
Kuorumi i nevojshëm:	7 anëtarë

Kjo mbledhje do të organizohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, në prezencë të Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të ftuar përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Programet EU4JUSTICE dhe OPDAT. Media si gjithmonë është e ftuar të jetë e pranishme.

Rendi i ditës:

1. Diskutimi/miratimi i listës me emrat e kandidatëve që kanë aplikuar në procedurën e lëvizjes paralele të shpallura me Vendimin nr.13, datë 16.02.2024, “Për shpalljen e 18 (tetëmbëdhjetë) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe hedhja e shortit për caktimin e relatorëve përkatës;
2. Diskutimi/miratimi i projektaktit “Për miratimin e listës me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet kualifikuese për ngritjen në detyrë në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë dhe fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre”;
3. Diskutimi/miratimi i projektaktit “Për caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”;
4. Diskutimi/miratimi i projektaktit “Për caktim të përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat”;
5. Diskutimi/miratimi i projektaktit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për prokuroren Fahrije Gjana (Vata)”;
6. Diskutimi/miratimi i projektaktit “Për caktimin e datës së seancës dëgjimore për magjistratin S.M”.

Të tjera (*pyetje/diskutime*).

Urdhërohet sektori i dokumentimit të seancave të bëj publikimin e kësaj axhende në faqen web të Këshillit.

Njoftohen të gjithë anëtarët e Këshillit për të siguruar pjesëmarrjen

Kryetar
Alfred Balla